



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I LARTE GJYQESOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr.612, datë 16.10.2024

PËR

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 238 DATË 02.05.2024, PËR KANDIDATIT ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 16.10.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.238 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,

VËREN

I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET

1 Me Vendimin nr.233- nr.243, datë 02.05.2024 dhe nr.260, datë 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit ishte data 16.05.2024 dhe data 30.05.2024.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024 kandidoi edhe znj. {...} gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

4. Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 239/2024 mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 297, datë 05.06.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësimë etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

II. TË DHËNA MBI PROCEDURAT

5. Me Vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/ Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”, Këshilli ka vendosur:

“3.Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, Tiranë, dhe Fier të shpallura me vendimet nr. 234, 235, 236, 237, 238, 239, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim..

4. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...9. Për kandidatin znj. {...} - relator z. Alban Toro;...”

6. Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit të tij për lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me Vendimin nr. 409, datë 30.07.2024, ka vendosur:

1.Kualifikimin e kandidatit znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMI

7. Në vijim të procedura, më datë 23.09.2024 kandidati znj.{...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 238 datë 02.05.2024, në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4546 prot., datë 23.09.2024.

8. Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky vendim bazuar në pikën 29, Seksioni Ç, Kreun IV, të Vendimit të Këshillit nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, ku përcaktohet se: “Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e lëvizjes paralele, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim.”. si dhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.”

9. Në Mbledhjen e datës 26.09.2024 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për kandidatin znj. {...}, si dhe po ashtu, vlerësoi

të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidati për t'u tërhequr nga kandidimi në procedurën e lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 238 datë 02.05.2024, bazuar në pikën 63, Seksioni Ç, Kreu V, të Vendimit nr. 320/2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure lëvizjeje paralele për kandidatin znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi.

IV. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATIT

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja "a", është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit për Statusin.

11. Këshilli, në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 43 të Ligjit për Statusin i ndryshuar, procedura administrative për lëvizjen paralele të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t'u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: *"Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka"*. Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: *"Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë"*.

12. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 320/2020. Kështu, në Kreun IV, Seksioni Ç, pika 29, të tij, përcaktohet se: *"Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e lëvizjes paralele, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim"*.

13. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara, konstatohet se kandidati znj {...}, brenda afatit të kandidimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje nga procedura e lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 238 datë 20.05.2024. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit të kushteve të tjera ligjore për lëvizjen paralele për këtë pozicion të lirë, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim final, kandidati u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë lëvizjeje paralele, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin për t'u tërhequr nga kandidimi.

V. KONKLUZIONE

14. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidati znj. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin për t'u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë , për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 238, datë 02.05.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidatë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për kandidatin znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR